



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:123643

Datë: 05.12.2023

Numri i dokumentit: 05018068

P.nr. 648/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kaltrina Rexhepi - Imami, në lëndën penale kundër të pandehurve: personi juridik “...” Sh. P. K me adresë në fsh. V. K. P, të cilën e përfaqëson av. A. N. nga P, me autorizim, për shkak të veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par. 1 të KPRK-së dhe personit përgjegjës A. K. nga fsh. P. K. P, për shkak të veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr. 1367/20, të datës 29.09.2020, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 04.12.2023, në prani të prokurorit të shtetit L. H, të pandehurit A. K, përfaqësuesit të personit juridik A. T. Sh. P. K, av. A. N, sipas autorizimit, në të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 05.12.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurve:

1.Personit Juridik ‘A.T.’ Sh. P.K. (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar), me pronar A. K, me adresë në fsh .V. K. P, me veprimtari primare të aktivitetit-eksplotimi i zhavorrit.

2.Personit përgjegjës të personit juridik A. K, i lindur me datë ...në P, tani me vendbanim në fsh. P. K. P, i lindur nga babai Z.K, dhe nëna M. K , e vajzërisë Sh, i identifikuar në bazë të numrit personal....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

Konform nenit 362 par.1, nën par 1.1 të KPPK-së,

REFUZOHET AKTAKUZA

Ndaj personit Juridik ‘A. T.’ Sh. P.K (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar),

Gjëja se:

I. Me datë 09.05.2020, rreth orës 00:05 min, në fsh. V. K. P, duke shkelur ligjin dhe atë nenin 80 të Ligjit për Minierat dhe Minalet, shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore dhe atë zhavorr , në atë mënyrë që i pandehuri person juridik ‘A. T’ Sh. P. K. duke vepruar në kuadër të

veprimtarisë së tij siç është eksploatimi i zhavorrit, me datë 09.05.2020, pas pasur licencë nga KPMM angazhohet në aktivitet minerar me bazë zhavorri, duke përdor ekskavator për të nxjerr zhavorrin, i ngarkon në kamion, mirëpo hetohet nga Inspektorët e KPMM-së, të cilët i ndalojnë edhe punën,

-me çka kishte për të kryer veprën penale “ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit” nga neni 338 par. 1 të KPRK-së.

Ndaj të pandehurit personit përgjegjës të personit juridik A. K,

Gjëja se :

II. Me datë 09.05.2020, rreth orës 00:05 min, në fsh. V. K. P, duke shkelur ligjin dhe atë nenin 80 të Ligjit për Minierat dhe Mineralet, shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore dhe atë zhavorr, në atë mënyrë që i pandehuri pronar i kompanisë “A. T” Sh. P. K., angazhohet në aktivitet minerar me bazë zhavorri, duke vepruar në kuadër të veprimtarisë së tij siç është eksploatimi i zhavorrit , me datë 09.05.2020, pa pasur licencë nga KPMM, mirëpo hetohet nga Inspektorët e KPMM-së, të cilët i ndalojnë edhe punën,

- me çka kishte për të kryer veprën penale “ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit” nga neni 338 par. 1 të KPRK-së.

Për shkak të heqjes dorë të prokurorit të shtetit nga aktakuza.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm me datë 29.09.2020 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 1367/20, ndaj të pandehurve personit juridik “A .T.” Sh. P.K me adresë në fsh. V. K. P. dhe personit përgjegjës të personit juridik A. K. nga fsh. P. K. P, për shkak të veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par. 1 të KPRK-së.

Shqyrtimi fillestar në këtë çështje penale është mbajtur me datë 04.12.2023, dhe pas njoftimit të të pandehurit A. K. me të drejtat e tij, i njëjti shtoj nuk kam nevojë për mbrojtës, se për mbrojtës të personit juridik autorizoi av. A. N. që të përfaqësojë personin juridik, duke deklaruar se pasi që kam pranuar ftesën së bashku me aktakuzë vërejtë se në këtë aktakuzë akuzohem për të njëjtën veprë penale për të cilën me datë 19.01.2023 jam dënuar nga Gjykata Themelore në Pejë në lëndën 720/20, sipas aktakuzës PP/II.nr.719/20 të datës 19.10.2020 dhe konsideroj që kjo çështje është e konsideruar.

Përfaqësuesi i “A.T.” Sh .P. K, av. A. N. deklarojë që meqë kemi të bëjmë me çështje të gjykuar res judicata i propozojmë prokurores së shtetit që të heq dorë nga akuza dhe gjykata të e konfirmojë një gjë të tillë me aktvendim.

Prokurorja e shtetit deklarojë që pasi që analizova shkresat e lëndës vërej se për të njëjtën çështje penale janë ngritur dy kallëzime penale edhe atë një nga KPPMM me datë 08.06.2020 për të cilën është ngritur aktakuza PP/II.nr. 719/20 e datës 19.10.2020 dhe për këtë është marr aktgjykim dënues ku me datë 13.02.2023 aktgjykim i kësaj gjykate ka marr formën e plotfuqishme, gjithashtu me datë 21.09.2020 në prokurori ka arritur kallëzim penal nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë me nr. të rastit, për të njëjtën çështje penale dhe për këtë është ngritur aktakuza për të cilën ne jemi sot me nr. PP/II.nr. 1367/20 të datës 29.09.2020. Andaj pas analizimit të shkresave të lëndës që të dy lëndëve vërej se kemi të bëjmë me të njëjtën çështje penale të datave 09.05.2020 për të njëjtin lokacion, për të njëjti të pandehur dhe pasi që kjo çështje është gjykuar njëherë me aktgjykim të formës së prerë, unë heq dorë nga akuza PP/II.nr. 1367/20 të datës 29.09.2020.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 362 par.1 nën par 1.1 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqenëse prokurori i shtetit ka hoq dorë nga aktakuza PP/II.nr. 1367/20, të dt. 29.09.2020 dhe nga ndjekja penale ndaj të pandehurve personit juridik A.T. Sh. P. K me adresë në fsh. V. K. P. dhe personit përgjegjës A. K. nga fsh. P. K. P.

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate konform nenit 453 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.648/20 me datë 05.12.2023

Bashkëpunëtorja profesionale

Gj y q t a r i

Kaltrina Rexhepi Imami

Veton Ademaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.